



Datë: 09.03.2026

A.nr.67/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.67/2026, të datës 22.01.2026, të parashtruar nga ankuesi, V.G nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit, në çështjen juridike-administrative “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.67/2026, të datës 22.01.2026, e parashtruar nga ankuesi, V.G.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, V.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 22.01.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procesit të rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00018337, pozita e punës Ekspert Shqyrtues, i shpallur nga Organi Shqyrtues i Prokurimit më datë 30.07.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP), ndërsa, kjo e fundit, më datë 06.02.2026 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se OSHP-ja më datë 30.07.2025, ka shpall konkursin me Nr. Ref: RN00018337, për Grupin e prokurimit publik, pozita Ekspert Shqyrtues, numri i kërkuar dy (2), klasa profesionale 1, i hapur për aplikim nga data 31.07.2025 deri më datë 29.08.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti i është nënshtruar vlerësimit përmes

testit më shkrim, por që ankuesi nuk ka arritur që të grumbulloj pikët e nevojshëm për të kaluar në fazën e vlerësimit përmes vlerësimit më intervistë më gojë.

Me tej nga provat materiale të çështjes del se Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në OSHP më datë 26.12.2025 ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit, ku sipas këtij akti real rezulton se kandidatë fitues në këtë procedurë është shpallur V.I me gjithsej 84.8 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pyetjet e testit me shkrim kanë qenë joadekuate dhe të pasakta, diskriminim mbi integritetin e procesit të testimit, diskriminim i kandidatëve me përvojë në prokurim publik. Kërkon që ti aprovohet ankesa, të anulohet konkursi më numër reference: RN00018337, sepse OSHP pavarësisht vendimeve të KPSHCK-se vazhdon ti përsërit shkeljet serioze të legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji bazuar në të dhënat që posedon ka gjetur se kandidati G.D, më datë 20.01.2026 ka parashtruar ankesë në Këshill duke kontestuar procedurën e njëjtë të pranimit gjegjësisht procedurën më numër reference: RN00018337, ndërsa, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.60/2026, të datës 06.03.2026, ka aprovuar ankesën e ankuesit G.D duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit me Nr. Ref: RN00018337, pozita Ekspert Shqyrtues.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.67/2026, të datës 22.01.2026, ka të bëjë me procedurën e njëjtë të pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.60/2026, të datës 06.03.2026, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi këtë procedurë, si një nga qëllimet e ankuesit, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.67/2026, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundojë procedimin administrativ të filluar sipas ankesës më numër A.nr.67/2026, të datës 22.01.2026.

Kështu që, thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.67/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.G;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.